BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE - ALPEX SH.A.

VENDIMI TEKNIK Nr. 6-T

"Udhëzues mbi Publikimin e të Dhënave të ALPEX-it lidhur me Tregjet e Energjisë Elektrike"

Në mbështetje të dispozitave të përcaktuara në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Procedura e Tregtimit, konkretisht në seksionin G.2, siç janë në fuqi:

ALPEX sh.a miratoi:

1. Vendimin Teknik – Udhëzues mbi Publikimin e të Dhënave të ALPEX-it lidhur me Tregjet e Energjisë Elektrike.

2. Vendimi Teknik Nr. 6-T i paraqitet për njoftim Entit Rregullator të Energjisë - ERE dhe Zyrës së Rregullatorit për Energji - ZRrE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ADMINISTRATORI I ALPEX SH.A

Sokol Dishnica

Sokol Dishnica

Digitally signed by Sokol Dishnica
Date: 2026.10.22 13:27:00 +02'00'

Neni 1

Dispozita të Përgjithshme

Ky udhëzues hartohet në zbatim të Ligjit nr. 59/2026 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", si dhe në fuksion të seksionit: G.2 "*PROCEDURAT E KOMUNIKIMIT*" të Rregullve të Tregut të Energjisë Elektrike – Procedura e Tregtimit mbi "Udhëzuesin për Publikimin e të Dhënave të ALPEX-it".

Neni 2

Objekti

Ky udhëzues përcakton rregullat, procedurat dhe afatet për publikimin e të dhënave dhe informacionit të tregut të energjisë elektrike nga ALPEX sh.a

Neni 3

Parimet e Publikimit

ALPEX garanton që informacioni i publikuar të jetë i disponueshëm për të gjithë përdoruesit në të njëjtën kohë, pa diskriminim, i saktë, i plotë, i përditësuar dhe i aksesueshëm pa pagesë në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë.

Neni 4

Platforma e Publikimit

Të gjitha publikimet zyrtare kryhen në faqen zyrtare të ALPEX SH.A., www.alpex.al . Publikimi në këtë faqe elektronike konsiderohet publikim zyrtar për të gjithë pjesmarrësit e tregut.

Neni 5

Kategoritë e të Dhënave

Bazuar në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike të miratuara nga ERE dhe ZRrE, publikohen të paktën informacionet e mëposhtme:

a) Publikimi i Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike dhe Procedurave, varianti në fuqi;
b) Rezultatet e Tregut të Ditës në Avancë (Day-Ahead Market) për secilën Zonë Ofertimi;
c) Rezultatet e Tregut Brenda së Njëjtës Ditë (Intraday Market) për secilën Zonë Ofertimi;
d) Kurbat e grupuara dhe anonime të shitjes dhe blerjes të përfshira në Librin e Urdhërporosive Lokale;
e) Statistikat mbi numrin e përgjithshëm të Urdhërporosive Bllok të paraqitura dhe të pranuara, së bashku me shumën e sasive të ofruara dhe të pranuara të energjisë në Urdhërporosi në Bllok;
f) Tarifat fikse dhe variabël;
g) Raporte mujore dhe vjetore;
h) Njoftime për Tregun;
i) Çdo informacion tjetër që mund të përcaktohet si një Vendim i Autoritetit Rregullator mbi rekomandimin e ALPEX-it.

Neni 6

Mënyra e publikimit

Për çdo publikim që lidhet me të dhënat sipas nenit 5, Drejtoria e Operimit të Tregut nëpërmjet kanaleve elektronike të mundësuara nga ofruesi i shërbimit të website zyrtar të ALPEX si dhe koordinimit përkatës me ofruesin e shërbimit kryen publikimet përkatëse në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë.

Neni 7

Afatet e Publikimit

Publikimi i Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike dhe Procedurave, varianti në fuqi si dhe tarifat fikse dhe variabël publikohen sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 14 ditë kalendarike, pas miratimit të tyre. Rezultatet e Tregut të Ditës në Avancë (Day-Ahead Market) dhe Tregut Brenda së Njëjtës Ditë (Intraday Market) për secilën Zonë Ofertimi publikohen ditore brenda dy orë nga rezultati përfundimtar, kurbat e grupuara dhe anonime të shitjes dhe blerjes të përfshira në Librin e Urdhërporosive Lokale si dhe statistikat mbi numrin e përgjithshëm të Urdhërporosive Bllok të paraqitura dhe të pranuara, së bashku me shumën e sasive të ofruara dhe të pranuara të energjisë në Urdhërporosi në Bllok publikohen ditore brenda dy orë nga rezultati përfundimtar kur

bëhen të vlefshme. Njoftime për Tregun në lidhje me mbarëvajtjen e tregtimit bëhet ditore dhe brenda dy ore pas ndodhisë përkatëse, në rast të ndodhisë. Raportet mujore publikohen brenda 15 ditëve pune pas përfundimit të muajit përkatës. Raportet vjetore publikohen jo më vonë se 30 ditë në vitin pasardhës. Njoftime për Tregun në lidhje me anëtarësimet kryhet brenda 10 ditëve pune pas hyrjes në fuqi të anëtarësimit përkatës.

Çdo informacion tjetër që mund të përcaktohet si një Vendim i Autoriteti Rregullator mbi rekomandimin e ALPEX-it bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 14 ditë kalendarike, pas miratimit të tyre.

Neni 8

Aksesi i Barabartë

Informacioni bëhet i disponueshëm njëkohësisht për të gjithë pjesëmarrësit e tregut, autoritetet, investitorët, median dhe publikun. Nuk lejohet publikimi selektiv apo shpërndarja paraprake e informacionit.

Neni 9

Konfidencialiteti

Nuk publikohen të dhëna që përbëjnë sekret tregtar, të dhëna personale ose informacione të mbrojtura me ligj. Kur është e nevojshme, të dhënat publikohen në formë të agreguar.

Neni 10

Korrigjimi i Informacionit

Në rast gabimesh, ALPEX publikon menjëherë korrigjimin, duke shënuar datën, orën, versionin, natyrën dhe arsyen e korrigjimit.

Neni 11

Arkivimi

Të gjitha publikimet te paraqituara ne nenin 5 pika b, c, d dhe e ruhen në faqen zyrtare të ALPEX-it për një periudhë një vjeçare.

Neni 12

Monitorimi dhe Përgjegjësitë

Drejtoria përgjegjëse, Drejtoria e Operimit të Tregut dhe Sektori i Zhvillimit të Biznesit monitorojnë zbatimin e këtij udhëzuesi.

Neni 13

Hyrja në Fuqi

Ky Vendim Teknik hyn në fuqi më datë 09.09.2026.

Ky Vendim Teknik do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të ALPEX www.alpex.al